

FËMIJËT NËN DIKTATURËN KOMUNISTE

Pasojat psiko-sociale

Najada Pendavinji

najadapendavinji@gmail.com

BIO

Ka mbaruar studimet e larta tek Departamenti Histori-Gjeografi pranë Universitetit Fan. S Noli në qytetin e Korçës. Në vitin 2023, ka qenë bashkëautore në realizimin e Projektit "Awareness Raising of Institutions & the Community on Communist Regime Crimes (Ndërgjegjësimi i Institucioneve dhe Komunitetit për Krimet e Regjimit Komunist", implementuar nga BIRN Hub, financuar nga Bashkimi Evropian). Aktualisht është studiuese dhe bashkëpunëtore e Fondacionit Kujto.al/ Arkiva online e Krimeve dhe Viktimave të komunizmit në Shqipëri. Me një përvojë 7 vjeçare në zbardhjen e dëshmimeve dhe dokumentave të krimeve të komunizmit dhe realizimin e intervistave në formën e artikujve dhe dokumentarëve me ish-të përndjekurit nga regjimi komunist në qytetin e Korçës dhe jo vetëm.

Abstrakt

Gjysma e dytë e shekullit XX ishte fatale për fatet e popullsisë sonë. Në Shqipërinë komuniste, edhe fëmijët ishin plotësisht të tepërt, sikurse ndodhi me regjimet totalitare. “Ata qenë të shtrënguar të hiqnin në kurriz një makth shtypjeje politike, një botë e përbërë nga policia e fshehtë, ekzekutime, informatorë, arrestime të kryera në mesnatë, kampe pune dhe internime”¹. Parimi kryesor mbi të cilin u mbështetën komunistët gjatë gjithë sundimit të tyre ishte goditja e kundërshtarëve jo vetëm drejtpërdrejt por duke vijuar me të gjithë trashëgimtarët e tyre në disa breza. Studimi ka si objektiv primar që të nxjerrë në pah intesitetin e përndjekjes komuniste duke u fokusuar tek pjesa më e brishtë dhe e pafajshme e shoqërisë tek fëmijët. Këta të fundit, të cilët nuk ishin të pakët nuk u kursyen nga regjimi dhe u gjendën përballë një realiteti që i shpallte fajtorë të deklaruar sepse ishin fëmijët e “armiqve të popullit”. Fëmijët e kësaj shtrese ishin më të mjerët në Shqipërinë socialiste, ata i ndoqi lufta e klasave deri në pafundësi, breza të tërë që lindën e u rritën pa liri, internimeve ndër kapanoneve, pa ujë të pijshëm, pa dritë, pa kushtet minimale të higjienës. Kjo ishte padrejtësia më e madhe që i bëhej foshnjave, fëmijëve nga regjimi diktatorial

¹ Fischer, Bernd “Enver Hoxha dhe diktatura staliniste në Shqipëri”, AIIS, Tiranë, 2010, f. 14

duke përjetuar tmerre e tortura, e duke u përjashtuar dhe diferencuar nga shoqëria. Padrejtësi e cila i ndoqi në çdo hap të jetës së tyre. Fëmijë të burgosur që u rritën dhe u plakën nëpër burgje dhe në kampet e punës, janë cilësuar si skllëvërit e Shqipërisë socialiste që thanë moçale, hapën kanale, bënë ndërtime të fabrikave, punuan në minierë vetëm për shkak të fajeve imagjinare të prindërve të tyre, viktimat të ideologjisë kriminale komuniste. Të gjitha këto e bënë të pamunduar jetesën e kësaj pjese të shoqërisë edhe jashtë kampeve të internimit. Breza fëmijësh u rritën me bindjen që “revolucionin” kërkonte viktimat dhe ata ishin kurbani i tij. Megjithatë propaganda e kuqe i konsideronte fëmijët si pronë e saj që kur diktatori Hoxha ishte shpallur “babai i kombit dhe fëmijët ishin “fëmijë të nënës Shqipëri” kjo pjesë, fëmijët e armiqve të popullit e kishin të pamundur të bënin një jetë normale. Në këtë aspekt studimi ka për qëllim që të jetë edhe një studim krahasues. Pikësisht duke krahasuar kushtet dhe nivelin e fëmijëve të familjeve të deklasuar pra “armiqve të popullit”, me fëmijët e familjeve që i shërbenin partisë, për të kuptuar në të vërtetë diferencën e pamundur midis bashkëmoshatarëve. Një vëmendje e veçantë do t’i kushtohet edhe elementit të agjentëve sekretë dhe bashkëpunëtorëve të Sigurimit për të kuptuar rëndësinë psikike tek fëmijët dhe për të pasqyruar në mënyrë sa më reale, formën sesi ka funksionuar ky sistem shtypës. Nga e gjithë trashëgimia e kujtimeve dhe dëshmive që na vjen nga të mbijetuarit që u bënë pjesë e këtij kalvari të gjatë persekutimesh në fokusin e këtij studimi do të vihet historia e Marjana Plasoti Rondo dhe Gani Sulka të dy nga rajoni i Korçës. Do trajtohet në mënyrë specifike i gjithë intesiteti i përndjekjes, duke nxjerrë në pah pasojat psiko-sociale të cilat kanë ndikuar në formimin dhe ndërtimin e personalitetit të tyre brenda një diktature. Përvoja dhe përjetimi i tyre, sjellin një kontribut modest në mënyrë që të kuptojmë të vërtetën mbi ekzistencën e krimeve komuniste të cilat kanë lënë gjurmë të pashlyeshme në kujtesën kolektive të vet shoqërisë shqiptare.

